



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2023:022477

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05733073

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM PENAL, gjyqtarja e vetme gjykuese Hakile Ilazi me pjesëmarrjen e praktikantes së kësaj gjykate Altinë Maliqi, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.S., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 1 të KPRK- së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II nr.1836/22 të datës 20.01.2023, në praninë e prokurorit të shtetit Mimoza Sylja Hyseni, përfaqësuesit të të dëmtuarit Av.Behar Sejda si dhe të akuzuarit R.S., pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik më datë 15.05.2024, mori dhe publikisht shpalli, kurse me datë 27.05.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: R.S., i lindur me .., nga i ati S.. dhe e ëma X.. e gjinisë Z.. me vendbanim rrugën “S.. Komuna Shtime, i martuar, baba i pesë fëmijëve, me profesion fasader, ka të kryer shkollën e fillore, shqiptarë, shtetas e Republikës së Kosovës, me numër personal 2....

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me 04 Nëntor 2022, rreth orës 16:00, në fshatin T., Komuna Shtime, saktësisht në pyllin priavt pronë e të dëmtuarit S.B., me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë rreth 3.00m3, të cilat i ka bartur me traktor F.. 5.., pastaj janë sekuestruar nga policia,-

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 46, 48, 50, 69, dhe 70 të KPRK-së si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurin e

G J Y K O N

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 / tre / MUAJ, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës kohore prej 1 / një / VITI pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

I dëmtuari S.B. nga fshati -Komuna Shtime, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I pandehuri lirohet prej shpenzimeve të procedurës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/IL.nr1836/22 të datës 20.01.2023 e ka ngarkuar të akuzuarin R.S., për shkak të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 15.05.2024, në të cilin shqyrtim të pranishëm ishin të pranishëm prokurori i shtetit Mimoza Sylja, Hyseni, në të cilin shqyrtim pas analizimit të shkresave ka bërë rikualifikimin e veprës penale nga paragrafi 2 i veprës penale në veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 1 të KPRK-rikualifikimin e veprës penale përfaqësuesi i të dëmtuarit Av. Behar Sejda, si dhe të akuzuarit R.S..

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.05.2024, pasi që gjykata e ka udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 319 par. 1 dhe par.2 të KPPK-së dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit. Pasi që gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar në tërësi

aktakuzën, konform nenit 321 par.1 të KPPK-së i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari R.S. me rastin e deklaramit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar qysh në fillim të shqyrtimit gjyqësorë e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave të saj, se është i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimit të fajësisë, duke shtuar se pranimin e fajësisë e bënë në shenjë pendimi për veprën të kryer.

Meqë i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtarja e vetme gjykuese duke vepruar në pajtim me nenin 322 par. 1 të KPPK-së ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 242 par.2 të KPPK-së: i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresën e lëndës siç janë: raporti i oficerit, deklarata e të dëmtuarit, deklarata e të pandehurit, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve dt.04.11.2022, vërtetimi mbi kthimin e gjëseneve dt.18.11.2022 si dhe fotografitë që gjenden në shkresat e lëndës.

Fjala përfundimtare e palëve

Pasi që gjykata ka konstatuar se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, konform nenit 350 të KPPK-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Mimoza Sylja Hyseni në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se konform nenit 351 të KPRK- së paraqet fjalën përfundimtare kundër të akuzuarit R.S. për veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK- së, mbetet pranë aktakuzës me numër PP/II.nr.1836/2022 e datës 20.01.2023, pasi që i akuzuari në këtë shqyrtim gjyqësor e ka pranuar fajësinë dhe ky pranim është bërë konform nenit 242 të KPPK- së dhe mbështet në faktet që përmban aktakuza, andaj e njëjta i propozon gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe që të i shqiptojë sanksionin e paraparë me ligj. Ndërsa me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit, gjykata të marrë parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtimin gjyqësorë,

ndërsa si rrethanë rënduese të merret parasysh intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur palës së dëmtuar.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit Av.Behar Sejda në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, shton se nuk i bashkangjitet ndjekjes penale dhe paraqet kërkesë pasurore-juridike.

I akuzuari R.S. në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se është penduar thellë, ka kërkuar falje publike, duke shtuar se është i gjendjes së dobët ekonomike dhe se edhe kur ka ndodhur rasti në fjalë i ka kërkuar falje të dëmtuarit dhe e ka kontaktuar në telefon, premtan se nuk do të përsërisë më vepra të tilla penale, si dhe e ka lutur gjykatën që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe t'i shqiptoj një dënim sa më të butë.

Të gjeturat e gjykatës, matja dhe shqiptimi i dënimit

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të KPRK-së, ashtu siç është theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin gjyqësor i akuzuari e ka pranuar fajësinë, duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, faktin se i dëmtuari nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale, gjendjen e dobët ekonomike, baba i pesë fëmijëve përkatësisht mbajtës i familjes m mbajtës i familjes, premtimin se nuk do ta përsërisë kurrë më në të ardhmen, faktin se i njëjti nuk ka rezultuar të ketë qenë i gjykuar më parë me vendim të formës së prerë, ndërsa në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përveç që vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit si dhe gjykata mori parasysh edhe peshën e veprës penale për të cilën është akuzuar.

Prandaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i shqiptoi dënim ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është

adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

Vendimi për udhëzimin e të dëmtuarit në kontest civil është marrë konform nenit 462 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 453 par. 1 të KPPRK-së, pasi që i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, andaj gjykata konstaton se mbulimi i këtyre shpenzimeve nga ana e të akuzuarit do ta rëndonte edhe me shumë gjendjen e tij ekonomike, pasi që i njëjti është mbajtës i familjes.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
2023:022478, me datë 27.05.2024

Praktikantja

Altinë Maliqi

Gjyqtarja e vetme gjyquese

Hakile Ilazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Ferizaj.

Numri i lëndës: 2023:022477
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05733073